

UDHËZIM
Nr. 285, datë 27.8.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 269, DATË 11.8.2020, TË
MINISTRIT TË KULTURËS, “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTEVE STANDARDE
TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE TË PAJISURA
ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË
PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE
NË PASURITË KULTURORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 11, kreu II, të vendimit nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, ministri i Kulturës

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 269, datë 11.8.2020, të ministrit të Kulturës, bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen 1, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Titulli i kreut I.2. “KËRKESAT PËR KUALIFIKIM DHE KRITERET PËR VLERËSIM” dhe titulli i nënkreut I. “Kriteret e përgjithshme për kualifikim”, ndryshon si më poshtë:

“Kreut I.2. ‘KËRKESAT DHE KRITERET PËR KUALIFIKIM’

I. ‘Kriteret për kualifikim’”.

b) Paragrafi i parë i nënkreut II ndryshon si më poshtë:

“Në rastin e bashkimit të subjekteve, njëri prej tyre i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kriteret sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit, të listuara më sipër, përkatësisht gjerat “a”, “b”, “c”, “ç”, ndërsa kriteret e përcaktuara në gjerat “d”, “dh”, “e”, “ë”, kriteret do të plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi i operatorëve, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.”.

c) Në shtojcën 3, togfjalëshi “fondi rezervë 5 %” bëhet “fondi rezervë 20 %”.

2. Në lidhjen 2 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në seksioni 4.1 “Lloji i procedurës: Shërbim konsulence”, paragrafi i dytë i fazës 1 – “Shprehja e interesit dhe parakualifikimi (lista e shkurtër)”, ndryshon si më poshtë:

“Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën 1 (një) kandidat”.

3. Në lidhjen 3 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Titulli i kreut I.2. “KËRKESAT PËR KUALIFIKIM DHE KRITERET PËR VLERËSIM” dhe titulli i nënkreut I. “Kriteret e përgjithshme për kualifikim”, ndryshon si më poshtë:

“Kreut I.2. ‘KËRKESAT DHE KRITERET PËR KUALIFIKIM’

I. ‘Kriteret për kualifikim’”.

b) Paragrafi i parë i nënkreut II ndryshon si më poshtë:

“Në rastin e bashkimit të subjekteve, njëri prej tyre i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kriteret, sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit, të

listuara më sipër, përkatësisht germat “a”, “b”, “c”, “ç”, ndërsa kriteret e përcaktuara në germat “d”, “dh”, “e”, “ë”, kriteret do të plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi i operatorëve, sipas natyrës së shërbimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.”.

4. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.5.2020, të ndryshuar, apo institucione të tjera të autorizuara nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti